

20040681278

**L I G J I**  
**PËR GARANTIMIN E KTHIMIT TË MJETEVE TË CILAT BANKA EUROPIANE PËR**  
**RINDËRTIM DHE ZHVILLIM I VË NË DISPOZICION TË QEVERISË SË**  
**REPUBLIKËS TË MAQEDONISË NË PROCESIN E PARAPRIVATIZIMIT, PËR**  
**FITIMIN E AKSIONEVE GJATË PRIVATIZIMIT TË SHA EEM**

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton kthimin e mjeteve, në shumë deri më 45 milionë euro ndaj Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me seli në Londër.

Në procesin e paraprivatizimit të Elektroekonomisë së Maqedonisë, Shoqëri Aksionare për prodhimtari, përçarje dhe distribuim të energjisë elektrike, në pronësi shtetërore (në tekstin e mëtejme SHA Elektroekonomia e Maqedonisë) BERZH i vë në dispozicion Qeverisë së Republikës të Maqedonisë mjete në shumë deri më 45 milionë euro, me qëllim të fitimit të së drejtës për fitimin e aksioneve gjatë privatizimit të Elektroekonomisë së Maqedonisë, Shoqëri Aksionare për prodhim, distribuim dhe furnizim me energji elektrike, në pronësi shtetërore, me emër të shkurtuar SHA EEM.

Neni 2

Kushtet për marrjen e mjeteve, të drejtat, obligimet e Republikës së Maqedonisë dhe kushtet, të drejtat dhe obligimet e BERZH-it rreth fitimit të aksioneve gjatë privatizimit të SHA EEM, do të rregullohen me Marrëveshje për shitje kushtimore kohore të aksioneve për paraprivatizimin e SHA Elektroekonomia e Maqedonisë, e cila do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës të Maqedonisë dhe BERZH-it.

Neni 3

Shumës së tërhequr, nga shuma në dispozicion prej gjithsejt 45 milionë euro, do t'i kalkulojen shpenzimet për mjete të ceduara sipas shkallës EURIBOR + 1% prej ditës së tërheqjes së transhave veç e veç, gjatë së cilës:

a) shpenzimet mund të kapitalizohen në afat jo më të gjatë se 24 muaj nga çasti i tërheqjes së transhës së parë prej ose deri në çastin e lajmërimit përfundimtar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ose prej BERZH-it, për fitimin ose për heqjen dorë nga blerja e aksioneve gjatë privatizimit të SHA EEM, ose

b) shpenzimet e kalkuluara t'i paguhen BERZH-it në ditën e transferit të aksioneve të SHA EEM.

Neni 4

Republika e Maqedonisë, do t'i servisojë tërësisht ose pjesërisht obligimet financiare ndaj BERZH-it pas ngjarjes të disa nga rastet në vijim:

a) në qoftë se BERZH dërgon lajmërim të përvokueshëm në formë të shkruar, në të cilin ka shënuar se nuk don të fitojë (blejë) aksione të SHA EEM;

b) pas skadimit të 70 ditëve pasi që BERZH do të dërgojë te Qeveria e Republikës së Maqedonisë lajmërim për qëllim të heqjes dorë nga aksionet në shoqëri. Në periudhën prej 70 ditëve është e përfshirë edhe periudha prej 60 ditëve, e parashikuar për konsultime ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BERZH;

c) në qoftë se në afatin prej 24 muajve të parashikuar për privatizimin e SHA Elektroekonomia e Maqedonisë, nuk bëhet privatizimi i 51% të pjesës së SHA EEM të paraparatë për privatizim;

ç) në qoftë se BERZH shfrytëzon vetëm pjesë të shumës së përgjithshme prej 45 milionë euro të destinuar për blerjen e aksioneve;

d) në qoftë se privatizimi i SHA EEM denoncohet para kohe dhe nuk realizohet për shkak të rrethanave të cilat nuk janë nën kontrollin e Qeverisë së Republikës të Maqedonisë;

dh) në qoftë se pas skadimit të 70 ditëve prej dërgimit të lajmërimit me shkrim nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë të BERZH për qëllimin e heqjes dorë nga shitja e aksioneve në SHA EEM dhe anulimit të privatizimit të SHA EEM. Në periudhën prej 70 ditëve është e përfshirë edhe periudha prej 60 ditëve, e parashikuar për konsultime ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BERZH.

#### Neni 5

Vetëm në rast të heqjes dorë nga privatizimi i SHA EEM ose anulimit të privatizimit të SHA EEM nga ana e Qeverisë së Republikës të Maqedonisë, në pajtim me nenin 4, pika dh) e këtij ligji, shumës së tërhequr të mjeteve do t'i kalkuloohen shpenzimet për mjetet e ceduara sipas shkallës EURIBOR+2,5% në vit.

#### Neni 6

Republika e Maqedonisë do ta kryejë pagimin e obligimeve financiare ndaj BERZH gjatë ngjarjes së rasteve nga neni 4 i këtij ligji në afat prej:

a) 181 ditësh nga data e ngjarjes së rasteve relevante dhe/ose të shoqëruara me pranimin ose dërgimin e lajmërimeve me shkrim prej Qeverisë së Republikës të Maqedonisë ose prej BERZH-it; ose

b) 5 vjet në 10 këste të njëjta gjysmëvjetore, pas njoftimit me shkrim nga BERZH, gjatë së cilave, shumës së përgjithshme ose një pjese të shumës së mjeteve të tërhequra të zmadhuar për shpenzime të kalkuluara dhe kapitalizuara për mjete të ceduara, do të kalkulohet kamatë sipas shkallës kamatore të EURIBOR +1% në vit.

#### Neni 7

Republika e Maqedonisë, obligimet për kamatë e cila do të kalkulohet në këstet e papaguara nga neni 6, pika b) e këtij ligji, do t'i paguajë çdo gjysmëvjetor, njëkohësisht me pagimin e kësteve.

#### Neni 8

Në rast të servisimit të vonuar të obligimeve ose transferimit të vonuar të aksioneve, BERZH do të kalkulojë dhe do ta ngarkojë Republikën e Maqedonisë me kamatë vonesë në lartësi prej EURIBOR +2% në vjet, në shumën e pagesës së vonuar.

#### Neni 9

Republika e Maqedonisë mund të dakordohet që shumata e papaguar e mjeteve nga neni 6, pika b) e këtij ligji, të shndërrohet në aksione gjatë të cilitdo privatizim të ardhshëm të SHA EEM, në qoftë se BERZH shpreh interes.

#### Neni 10

Mjetet e tërhequra nga neni 1, paragrafi 2 i këtij ligji, janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Mjetet për servisimin e obligimit nga neni 1, paragrafi 1 i këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Mjetet e realizuara nga shitja e aksioneve të SHA EEM ose pjesë të SHA EEM, gjegjësisht mjetet e realizuara nga shitja e mjeteve themelore në procesin e transformimit dhe privatizimit të SHA Elektroekonomia e Maqedonisë, janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".